



Ky projekt financohet nga  
fondet e Bashkimit Europian

**dimö**  
DESTINATION MANAGEMENT ORGANIZATION



# ENERGJIA

PRAKTIKA INOVATIVE PER MBROJTJEN E MJEDISIT

# Energjia, perkufizimi

Energjia eshte aftesia per te kryer pune. Energjia matet me xhaul, simboli J.

$$1J = 1N \times m$$

## Format e energjise

Energjia mekanike - energji kinetike dhe energji potenciale, energjia termike, energjia kimike, energjia atomike, energjia elektrike, etj. Nje forme energjie kalon ne nje forme tjeter te energjise. Energji primare eshte energjia e prodhuar ne menyre natyrale, forma e ekzistences se saj ne natyre.

Perdorimi i energjise prej shoqerise shpeshhere kerkon transformimin e saj ne nje forme tjeter para se te perdoret prej konsumatorit. Forma me e perhapur e energjise se transformuar eshte energjia elektrike. Forma e fundit, ajo qe perdoret direkt prej konsumatorit eshte energjia fundore.



## Energjia e rinovueshme

Sot ne bote peshen kryesore te energjise se konsumuar nga shoqeria e ze energjia e prodhuar prej burimeve te parinovueshme, ose sic quhen – burimeve fosile. Keta burime jane nafta, gazi natyror, qymyret. Kjo energji ne shume vende , si kunder edhe ne nivel global, kapin perqindje shume te larta, mbi 80% ne bilancin e pergjithshem energjistik. Dy jane arsyet madhore qe e kane kthyer ne domosdoshmeri reduktimin maksimal te kesaj energjie :

- Jane burime qe prodhojne energji prej djegies se tyre, proces i cili ngarkon ajrin me sasi te medha te gazit karbonik, gazit metan e ndonje tjeter, gazra keta qe shkaktojne ‚Efektin Serre‘ dhe per pasoje, mbingrohjen e globit.
- Burimet fosile jane te shterrshem dhe, me ritmet qe po shfrytezohen sot, nafta dhe gazi mund te perfundojne si rezerva natyrore te planetit brenda nje periudhe relativisht te shkurter , 50 – 100 vjet.





Energji e rinovueshme konsiderohet ajo energji qe prodhohet prej burimeve te rinovueshem. Burime te rinovueshme te energjise jane era, uji, rrezatimi diellor, burimet gjeotermike te nentokes, biomasa. Keshtu sot po zhvillohen me shpejtesi shume projekte te prodhimit dhe perdorimit te energjies se rinovueshme si centralet e eres, panelet diellore per ngrohje dhe per prodhim te energjise elektrike, hidrocentralet, sistemet e nrgohje me agjent ngrohjes ujin, qe perdorin energjine gjeotermike, druri si prodhim natyror organik perdoret gjeresisht si burim per ngrohje, duke rritur ndjeshem shkallen e perdorimit te tij, biomasa e gjelber perdoret per prodhimin e biokarburanteve. Objektiva te rendesishem jane vendosur ne BE dhe OKB per rritjen e peshes se energjise se rinovueshme ne kuadrin e energjise se pergjithshme te perdorur.

# Eficiencia e energjise

Popullsia e botes po rritet panderprere, ne fund te shekullit parashikohet te jete rreth 9 miliard. Cdo popull ne cdo vend te botes punon per te rritur nivelin jeteses, per te prodhuar me shume, per te konsumuar me shume te mira materiale dhe sherbime. Ne anen tjetere, burimet natyrore te planetit jane te kufizuara, nje pjese e tyre madje te rrezikuara te mbarojne shpejt. Prodhimi i energjise eshte ne pararoje te prodhimit njerezor. Eshte energjia qe ndikon ne cdo proces zhvillimi ekonomik, industrial, bujqesor, social. Eshte energjia qe prodhon pune. Edhe nje parashtrim kaq i shkurter na qarteson per objektivat madhore aktuale ne fushen e energjise. Mund t'i permbledhim ne dy :

1. Prodhimi i energjise te bazohet me fuqishem ne burimet e rinovueshme te energjise.
2. Te rritet eficiencia e perdorimit te energjise, duke ulur keshtu konsumin e energjise pa rrezikuar prekjen e nivelit te jeteses.

Mos shperdorimi i energjise eshte natyrshem edhe perdorim me eficiencia i saj.

## HUMBJET E NXEHTESISE

**Min.**

**A**

**B**

**C**

**D**

**E**

**F**

**G**

**Max.**





## **Mekanizmi i Zhvillimit te Paster – Kreditet e karbonit**

Banka Boterore, si institucion i fuqishem financiar, kreditues dhe investues, si nxitet e programues i zhvillimit te qendrueshem, per te nxitur prodhimin e energjise prej burimeve te rinovueshme, per te frenuar keshtu mbingrohjen e globit dhe ,Efektin Serre' qe e shkakton, ka perpunuar vitet e fundit ate qe quhet ,Mekanizmi i Zhvillimit te Paster'. Cfare perfaqeson ky mekanizem ? Parimi eshte i thjeshte : Kush ndot ajrin me gazrat e ,Efektit Serre' paguan ne shkallen qe ndot, kush realizon aktivitetet qe reduktojne emetimin ne ajer te ketyre gazrave, shperblehet ne shkallen qe eviton apo redukton keta gazra. Per t'u zhvilluar ne praktike ky mekanizem duhen realizuar hallkat e nevojshme.

– Banka Boterore eshte udheheqesja e ketij procesi qe nderton gjithet metodologjine vleresuese, rregullat e aplikimit ne praktike, mareveshjet me shtetet qe pranojne aplikimin e Mekanizmit, normat e lejuara te emetimit te gazrave, dhe gjithcka te nevojshme tjeter.

- Institucionet vleresues te emetimit te gazrave prej subjekteve private. Jane kompani me ekspertize te larte ne kete fushe, te licencuara prej Bankes Boterore.

Organizimi i tregut te Krediteve te Karbonit. Qe te funksionojte Mekanizmi caktohen njesite baze te vleresimit, matjes. Keshtu 1 kredit karboni quhet detyrimi per t'u paguar nga ai qe emeton mbi normat e lejuara 1 ton gaz



karbonik ne ajer ne procesin teknologjik te prodhimit. 1 kredit karboni quhet gjithashtu vlera e shperblimit qe merr nje subjekt qe prodhon duke emetuar 1 ton gaz karbonik me poshte se norma e lejuar, ose ai subjekt qe me aktivitetin e vet i merr ajrit 1 ton gaz karbonik. Cmimi i nje krediti diktohet nga tregu. Emetimi apo reduktimi i emetimit maten fizikisht njelloj ne cdo cep te globit. Po ashtu, subjekti qe emeton mbi normat, pra ai qe duhet tepaguaje, mund ta beje kete ne cdo pjese te globit, ne cdo vend pra, mjaftonqeaitedemshperbleje duke paguarnjeaktivitetqereduktongazinkarbonik ne sasineqeai e kaemetuarmbinorme. Pra, nje kredit karboni mund te blihet me cmime te ndryshem ne vende te ndryshem, ne aktivitete te ndryshem. Ky eshte tregu i krediteve te karbonit. Perfituesit prej ketij Mekanizmi jane subjektet qe perdorin energjine e rinovueshme, subjektet qe rrisin eficiencen e perdorimit te energjise, pra qe e kursejne ate dhe, subjektet qe me aktivitetin e tyre thithin gazrat nga atmosfera, pyllzimet psh.



